




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA OF KOSOVA



**Gjykata Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjeve në Skenderaj**, me gjyqtarin Gani Veseli dhe procesmbajtset Florie Gucati, duke vendosur në çështjen kundërvajtëse kundër të pandehurit, Jashar Muharrem Lushtaku, nga fshati Prekaz i Poshtem, Komuna e Skenderajt, për shkak të kundërvajtjes të shkaktuar nga neni 17.al.1.pika 3 të Ligjit Antikorrupcion, Nr. 043/L – 50 të Republikës së Kosovës, lidhur me neni 9 dhe 10 të LMK-ës, si dhe në kuptim të nenëve 30,31,37,74,195, të Ligjit mbi kundërvajtjet, me dt.20.12.2013, mori:

## A K T V E N D I M

**I pandehuri** : I. Jashar Lushtaku, i lindur më 22.07.1954, në fshatin Prekaz i Poshtem, i punësuar, i martuar, me profesion ; Fakultetin e pedagogjisë, kushtet ekonomike të mesme, shqiptar - shtetas Kosovar.

## Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

**Sepse** në muajin Mars të vitit 2012, zyrtari i Lartë Publik, nuk ka përmesdhur obligimin Ligjor që parashihet me Ligjin 04/L-050, për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtërve të lartë publik. Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, ku nuk ju kanë papërmbytur nenit 9 të këtij Ligji.

Me këtë i pandehuri ka bërë kundërvajtje nga neni 17.al.1.pika 3, të Ligjit mbi deklarimin e pasurisë.

## D E N O H Ë T

**ME DËNIM Qortimi** për kundërvajtjen e shkaktuar nga neni 17 .al.1.pika 1 të Ligjit Antikorrupcion të Republikës së Kosovës.

I pandehuri ngarkohet me paushall gjuqësor në shumë prej 10 Euro, në kuptim të nenit 109.al.1.pika 6 të LMK-ës, pagesa e kësaj shume bëhet në arkën e kësaj gjykate në afatin prej 15 ditësh pasi që vendimi të merr formën e prerë.

Nga një kopje e këtij Aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit .

## A r s y e t i m i

Agjensioni Antikorrupcion, ushtroi kërkesën e vet, nr.01-2520/12 të dt.13.07.2012, me qëllim të hapjes dhe zhvillimit të procedurës kundërvajtëse, kundër të pandehurit të Lartëtheksuar, për kundërvajtjen e shkaktuar nga neni 17.al.1.pika 3 të Ligjit Antikorrupcion .

Gjykata pas shqimit të kërkesës të ushtuar nga ana Agjencionit Antikorrupcion, konstatoi se kërkesa i plotëson kushtet për zhvillimin e procedurës. Gjykata mori Konkluzion mbi zhvillimin e procedurës kundërvajtëse me dt. 27.02.2013 dhe caktoi senacën e shqyrtimit për dt. 15.10.2013, ndërsa në pyetje u muar me dt.29.10.2013, dhe në mbrojtjen e tij i pandehuri shtoi: është e vërtetë se unë formularin për deklarimin e pasurisë e kam dorguar përmes internetit me imellë në fund të muajit Mars. Pas disa ditësh kam marrë vërejtje se duhet dorëzuar me dorë dhe këtë e kam bërë me 18.04.2012.

Provë vërtetimi nr.03-3446/12- i cili mbetet në shkresat e lëndës.

Gjykata pas shqimit dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës si dhe nxjerrjes së provave në procedurë, erdhi në përfundim se i pandehuri Jashar nuk kishte përmesdhur obligimin ligjor- deklarimin e pasurisë përmes aplikacionit të Agjencionit Antikorrupcion për muajin Mars të vitit 2012. Këtë obligim e ka përmesdhur pas afatit të paraparë me Ligj, me dt. 18.04.2012. Prandaj me këtë i njëjti ka bërë veprë kundërvajtëse – mospërmesdhje të detyrimit të afatit ligjor për deklarimin e pasurisë . Për veprën kundërvajtëse të shkaktuar i njëjti mbanë përgjegjësi ligjore dhe Gjykata mu për këtë, të njëjtin e shpalli fajtor duke i shqiptuar një dënim qortimi në kuptim të nenëve 17.al.1.pika 3, lidhur me nenin 9 dhe 10 të LMK-ës.

Gjykata ndaj të pandehurit aplikoi nenet 9 dhe 10 të LMK-ës për zbutje të jashtëzakonshme - dënim Qortimi, për shkak se i pandehuri veprën kundërvajtëse nuk e ka bërë me qëllim, por kjo ka qenë si pasojë që i njëjti e ka bërë deklarimin e pasurisë përmes internetit – ndërsa ka qenë i obliguar që këtë ta bëjë përmes dorëzimit personal të aplikacionit.

Gjykata mori përbazë arsytimin – gjegjësishtë mbrojtjen e të pandehurit, duke i dhënë besim kësaj deklaratë se i njëjti e ka prezantuar formularin për deklarimin e pasurisë dhe se i njëjti këtë e ka bërë nga ajo që nuk e ka ditur procedurën e deklarimit.

Prandaj, Gjykata mendon se dënim i shqiptuar do ta arrijë qëllimin e vet dhe se është i mjaftueshëm për peshën e përgjegjësisë për veprën kundërvajtëse të kryer.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit mori parasyshë rrethanat lehtësuese dhe rënduese nda, të pandehurit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**Gjykata Themelore në Mitrovicë- dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni i Kundërvajtjeve në Skenderaj.**

Skenderaj, më dt.20.12.2013.



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës kanë të drejtë ankese, në afatin prej 8 ditësh, pas marrjes së këtij Aktvendimi, Gjykatës së Apelit, Departamentit të përgjithshëm – Divizionit të kundërvajtjeve Në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate